

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E MJEDISIT

**MENAXHIMI KIMIKATEVE  
DHE  
LEGJISLACIONI I RI NE KETE FUSHE**

**datë 25.11.2015, Tiranë**

## Legjislacioni egzistues i kimikateve

- Ligji Nr. 9108, datë 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike” dhe
- VKM Nr.824, datë 11.12.2003 “ Për klasifikimin, etiketimin, ambalazhimin dhe ruajtjen e kimikateve”

transpozojnë (deri në 70%) **Direktivën e Këshillit 76/769/EEC** mbi përafrimin e legjislacionit, rregullave dhe dispozitave administrative të shteteve anëtare në lidhje me *ndalimin e shitjeve dhe përdorimin e disa substancave e preparateve të rrezikshme*, dhe

**Direktivën e Këshillit 67/548/EEC** e datës 27 Qershor 1967 mbi përafrimin e legjislacionit, rregullave dhe dispozitave administrative në lidhje me *klasifikimin, paketimin, etiketimin dhe ruajtjen e sigurtë të substancave dhe preparateve të rrezikshme*.

## PSE ISHTE E NEVOJSHME NJE LIGJ I RI ?

- **Direktiva e Këshillit 76/769/EEC është shfuqizuar** nga Rregullorja (EC) Nr 1907/2006 e Parlamentit dhe Këshillit të Evropës e datës 18 Dhjetor 2006 lidhur me Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (**REACH**).
- **Direktiva e Këshillit 67/548/EEC është shfuqizuar** nga Rregullorja (EC) Nr 1272/2008 e Parlamentit dhe Këshillit të Evropës mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzjerjeve (**CLP**).
- **REACH-CLP konsiderohen si rregjimi i menaxhimit të kimikateve në BE.**
- REACH vendos në qendër krijimin e Agjensisë Evropiane të Kimikateve (**ECHA**), duke e centralizuar sistemin.
- Proçedurat e *rregjistrimit, vlerësimit, autorizimit dhe kufizimeve të kimikateve*, të cilat me parë (sipas direktivave të shfuqizuara) kryheshin nga vendet anëtare, tani këto **proçedura kryhen vetëm nga ECHA**. Roli i vendeve anëtare të BE-së lidhur me rregjistrimin është thjeshtuar. Vëndet anëtare kanë përfaqësuesit e tyre në komitetet teknike të Evropës.

## PSE ISHTE E NEVOJSHME NJE LIGJ I RI ?

Hartimi i projektligjit u vlerësua si i rëndësishëm për të **përafruar legjislacionin e BE-së**, duke adresuar edhe **rekomandimet e progres raporteve 2011-2014** në fushën e kimikateve:

- Nuk ka një autoritet të vetëm kompetent;
- Përgjegjësitë në fushën e kimikateve janë të shpërndara midis një numri të madh ministrish me përgjegjësi të paqarta, mbivendosje detyrash dhe kapacitete të dobta administrative;
- Rregjistri i substancave kimike dhe përzjerjeve si dhe sistemi i klasifikimit dhe etiketimit duhet të përshtatet me kërkesat e legjislacionit të BE-së;
- Nuk ka pasur përparim në fushën e *kimikateve*.

## PAKETA E RE LIGJORE E HARTUAR

- **5 TAIEX EXPERT MISSION** gjatë periudhës Nëntor 2014-Mars 2015, organizuar nga Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me Projektin ECRAN, njësinë TAIEX të KE-së dhe Agjensinë Suedeze të Kimikateve (KEMI)
- Projektligji **“Per menaxhimin e integruar te kimikateve”**
- Projektvendim *“Mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve”*
- Projektvendim **“Mbi importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikëshme”**
- Projektvendim *“Mbi kufizimet në prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar të rrezikshëm”*;
- Projektvendim **“Lista e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC), kriteret për përfshirjen e substancave në listën e svhc dhe lëshimi i një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimin e përdorimit të SVHC”**;

## CFARE SJELL LIGJI I RI ?

- Projektligji përcakton **1(një) autoritet kompetent** (Ministrinë e Mjedisit), që në rastin e fushës së kimikateve është shumë e rëndësishme të evitohet shpërndarja e përgjegjësive ndërmjet disa autoriteteve.
- Përgjegjësitë lidhur me *rregjistrimin, klasifikimin, etiketimin, paketimin, vlerësimin e sigurisë së kimikateve, dokumentin me të dhënat e sigurisë së kimikateve* etj, **bien mbi prodhuesit, importuesit dhe përdoruesit e tjerë** në zinxhirin e furnizimit të kimikateve.
- **Regjistrimi i kimikateve**, është detyrim për *prodhuesit dhe importuesit*, me qëllim **krijimin e një baze të dhënash në nivel kombëtar** që do të mbështesi autoritetet zbatuese dhe inspektuese në fushën e kimikateve, për të patur një pasqyrë të qartë të situatës në vend lidhur me llojin dhe sasinë e kimikateve, prodhuesit, importuesit dhe eksportuesit e tyre, për të garantuar menaxhimin e sigurt të kimikateve në vend.
- Përcakton rregullat **përpara vendosjes në treg** të një kimikati apo përzjerje kimikatesh, me qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit

## CFARE SJELL LIGJI RI ?

- Funkcionon paralelisht me legjislacionet e tjera specifike që **mbulon çështjet e sigurisë së kimikateve që lidhen me përdorimin e tyre**, duke siguruar zvogëlimin e riskut që vjen nga kimikatet
  - *Ligji lejeve te mjedisit,*
  - *ligji per parandalimin e aksidenteve madhore industriale për shkak të kimikateve,*
  - *Legjislacioni për sigurinë dhe shëndetin në punë,*
  - *Legjislacioni për transportin,*
  - *Legjislacioni për mbrojtjen e konsumatorit*
- Krijon një sistem menaxhimi kimikatesh **në linjë me atë të BE-së** dhe jo një sistem paralel apo që ta konkurojë atë;



## CFARE SJELL LIGJI RI ?

- Autoriteti kompetent si dhe prodhuesit, importuesit dhe përdoruesit në zinxhirin e furnizimit të kimikateve gjatë periudhës së hyrjes për në BE, do të përgatiten për të kryer të njëjtat detyra me ato që do të kryejnë kur të jemi vënd anëtar i BE-së;
- Rregullat mbi *klasifikimin, etiketimin, kërkesat për dokumentin e të dhënave të sigurisë (safety data sheet) dhe kufizimet lidhur me vendosjen në treg të kimikateve*, janë të vlefshme edhe për **produktet biocide dhe produktet e mbrojtjes së bimëve**.
- Duke mos krijuar një “mini” ECHA, ulen kostot dhe shpenzimet për financimin e strukturës së autoritetit kompetent, për të kryer të njëjtat detyra që kryhen ECHA në zbatim të REACH dhe CLP.



## PVKM “PËR KLASIFIKIMIN, ETIKETIMIN DHE PAKETIMIN E KIMIKATEVE”

Ky projektvendim percakton:

- a. Kriteret e klasifikimit të kimikateve dhe rregullave mbi etiketimin dhe paketimin e kimikateve të rrezikshme;
- b. detyrimet ndaj:
  - i. prodhuesve, importuesve dhe përdoruesve profesional për të klasifikuar kimikatet që vendosin në treg;
  - ii. furnizuesve, për etiketimin dhe paketimin e kimikateve;
  - iii. prodhuesve dhe importuesve të artikujve për klasifikimin e atyre substancave që nuk janë vendosur në treg, por që janë subjekt i regjistrimit dhe njoftimit në përputhje me ligjin «Për menaxhimin e integruar të kimikateve » ;
- c. krijimin e listës së substancave të klasifikuara dhe etiketuara në mënyrë të harmonizuar;
- d. krijimin e inventarit të klasifikimit dhe etiketimit të substancave.

## PVKM “PËR KLASIFIKIMIN, ETIKETIMIN DHE PAKETIMIN E KIMIKATEVE”

- Prodhuesi, importuesi dhe përdoruesi profesional i kimikateve, përpara vendosjes së tyre në treg, **klasifikon kimikatet** në përputhje me kete PVKM (Kapitulli II).
- Një substancë ose përzierje e **klasifikuar si e rrezikshme**, e ambalazhuar, **shoqërohet me etiketë**.
- Elementet kryesore te etiketes, jane **Deklaratat e Rrezikut dhe Deklaratat Parandaluese**.
- Rreziqet e kimikateve transmetohen nepermjet etiketes duke perdorur **Deklaratat Standarte dhe Piktogramet e rrezikut** por edhe nepermjet **Dokumentacionit me te dhenat e Sigurise (MSDS)**.

## PVKM “PËR KLASIFIKIMIN, ETIKETIMIN DHE PAKETIMIN E KIMIKATEVE”

- Sjell ne legjislacionin Shqiptar **dy instrumenta te gatshem** te cilet mund te zbatohen direkt nga industria vendase:

**1. Lista e Klasifikimit dhe Etiketimit te harmonizuar ne BE** (e perfshire në Aneksin VI), i siguron industrise vendase nje list te gatshme dhe klasifikime qe jane gati per tu perdorur

Kjo list perfshin **klasifikimin e plote te detyrueshem te gati 3000 substancave**, te klasifikuara per qellime te kontrollit te kimikateve dhe gati **1000 klasifikime te substancave** qe jane vleresuar si Kancerogjene, Mutagjene ose Toksike per riprodhimin te njeriu (CMR).

## **PVKM “PËR KLASIFIKIMIN, ETIKETIMIN DHE PAKETIMIN E KIMIKATEVE”**

**2. Inventari i ECHA-s per Klasifikimin dhe Etiketimin,** perben nje aset, nje instrument ekzistues, te nevojshem dhe qe perdoret gjeresisht ne bote, perdorimi i te cilit rekomandohet edhe per industrine tone.

- Eshte produkt i Rregullores 1272/2008, monitorohet dhe mirembahet per te siguruar se klasifikimet nuk bien ne kundërshtim me njera-tjetren;
- Perdorimi i tij, do ti jape industrise vendase **akses** ne klasifikimin e te gjitha **substancave qe jane te regjistruara ne tregun e BE-se.**

**PVKM “MBI KUFIZIMET PËR PRODHIMIN, VENDOSJEN NË TREG DHE PËRDORIMIN E DISA KIMIKATEVE DHE ARTIKUJVE TË CAKTUAR, TË RREZIKSHËM PËR SHËNDETIN E NJERIUT DHE MJEDISIT”**

- ***Transpozon pjeserisht*** Rregulloren (EC) Nr 1907/2006 e Parlamentit dhe Këshillit të Evropës e datës 18 Dhjetor 2006 lidhur me Rregjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (**REACH**) (**Aneksi XVII**)
- Propozon një **proces kufizimi** për të rregulluar *prodhimin, vendosjen në treg ose përdorimin* e substancave të caktuara ne forme te paster ose në përzierje apo artikuj, nëse përbëjnë një rrezik për shëndetin ose mjedisin.
- Këto aktivitete mund të jenë **të kufizuara apo edhe të ndalohen** nëse është e nevojshme.
- Kufizimet janë një mjet për të **menaxhuar rreziqet** që vijnë nga kimikatet dhe për të **mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin** nga kto rreziqe te papritura.

## **PVKM “MBI KUFIZIMET PËR PRODHIMIN, VENDOSJEN NË TREG DHE PËRDORIMIN E DISA KIMIKATEVE DHE ARTIKUJVE TË CAKTUAR, TË RREZIKSHËM PËR SHËNDETIN E NJERIUT DHE MJEDISIT”**

- Një substancë, në formën e saj të pastër, në një përzierje ose në një artikull, e cila **kufizohet sipas listës së kufizimeve** (Shtojca I), nuk do të prodhohet, vendoset në treg ose përdoret pas datës 1 Korrik 2019 nëse **nuk** është në përputhje me kushtet e atij kufizimi ose kur kushtet në Shtojcë nuk parashikojnë hyrjen në fuqi të kufizimeve, mbas kësaj date.
- Personat fizikë dhe juridikë që prodhojnë, importojnë, vendosin në treg apo përdorin një kimikat ose artikull, i cili kufizohet sipas listës së kufizimeve të Shtojcës 1, **njoftojnë** Ministrinë përgjegjëse për mjedisin për aktivitetet që kryejnë, përpara datës 1 Korrik 2017, duke dorezuar informacionin e përcaktuar.
- Bazuar në njoftimet e bëra, Ministria mer ne konsiderate **shtyrjen e afateve kohore** të hyrjes në fuqi të një kufizimi.
- Përpara datës 1 Korrik 2018, Ministria i propozon Këshillit të Ministrave vendimin për shtyrjen e afateve kohore të hyrjes në fuqi për çdo kufizim të përcaktuar në kapitullin I të Shtojcës 1.


## PVKM “PËR EKSPORTIN DHE IMPORTIN E KIMIKATEVE TË RREZIKSHME”

- **Transpozon** Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian **649/2012/KE** e datës 4 Korrik 2012, ne lidhje me eksportin dhe importin e kimikateve te rrezikshme, numri **CELEX 32012R0649**.
- Zbaton Konventen e Roterdamit dhe Zbatohet për kimikate industriale dhe pesticide (përfshirë biocidet) që janë të ndaluara apo rreptesisht të kufizuara për arsye shëndetësore apo mjedisore.
- Percakton AKP, institucionet pergjegjese dhe procedurat per import-eksportin.
- Vendos detyrime për **importuesit** e kimikateve të ndaluara ose rreptesisht të kufizuara nga legjislacioni specifik qe i mbulon apo qe i nënshtrohen procedurës PIC sipas Konventës së Roterdamit.
- Vendos detyrime për kompanitë që dëshirojnë **të eksportojnë** këto kimikate drejt vendeve qe jane ose jo Pale ne Konvente.  
Importi/Eksporti i ketyre kimikateve sipas rastit i nenshtrohet Njoftimit te Eksportit dhe Pergjigjes (eksplicite) te Importit.
- ❖ Importi i substancave kimike është i mbuluar kryesisht nga legjislacioni i BE-së: Rregullorja REACH (A.XVII), Rregulloret per Produktet Biocide dhe Produktet per Mbrojtjen e Bimeve.



PVKM “LISTA E SUBSTANCAVE ME RREZIKSHMËRI SHUMË TË LARTË (SVHC), KRITERET PËR PËRFSHIRJEN E SUBSTANCAVE NË LISTËN E SVHC DHE LËSHIMI I NJË AUTORIZIMI TË KUSHTËZUAR ME QELLIM VAZHDIMIN E PËRDORIMIT TË SVHC”

- **Transpozon** Anekset XIII, XIV dhe XVI të rregullores nr. 1907/2006, REACH
- Përcakton kriteret që duhet të plotësojnë Substancat e Qendrueshme, Bioakumulueshme dhe Toksike (QBT) dhe substancat shumë të Qendrueshme dhe shumë të bioakumulueshme (shQshB).
- Përcakton Listën e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC), të ndaluara për tu përdorur në BE (31).
- Për të patur një përdorim të kontrolluar të substancave SVHC deri në momentin që Shqipëria të bëhet vend anëtar i BE-së dhe kur përdoruesit do të duhet të ndjekin rregullat e autorizimit sipas REACH, ky projektvendim parashikon *Autorizimin e kushtëzuar për vazhdimin e përdorimit të SVHC*, që jepet për një përdorim specifik të një substance.
- Për 31 substanca/ grup substancash që gjenden në këto liste, është përcaktuar data përfundimtare kur lejohet vendosja në treg (*sun-set date*). Pas tejkalimit të kësaj date, **nuk lejohet** përdorimi i asaj substance pa autorizim. Autorizimi i kushtëzuar për vazhdimin e përdorimit të SVHC, do të jete e perkoheshme: nga data e ndalimit të SVHC deri në ditën e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.



**Ju Faleminderit per vemendjen!**

